

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-219/2015

**Prishtinë,
13 dhjetor 2017**

Në çështjen juridike të:

V J
Rruga "B i J Nr.30"
11253 S -B
S
Pala ankuese

kundër.

NSH "A" (në Likuidim)

E përfaqësuar nga:

A K e P
Rruga "R M" Nr.
P

E përfaqësuar nga:
M S (zyrtar ligjor)

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Isa Kelmendi, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015 të datës 30 mars 2015 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13242), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 13 dhjetor 2017, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohen si të pabazuara ankesat e V J kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015 për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13242.
2. Vërtetohet Vendimi KPCC/D/A/267/2015 për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13242.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 10 tetor 2006, V J (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka paraqitur katër kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) ku kërkonte ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 9551298/6, tokë e kultivuar me sipërfaqe prej 1.60.00 ha, që ndodhet në fshatin Gushicë, Komuna e Vitisë, (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Ai kishte deklaruar se familja e tij e kishte fituar pronën e kërkuar përmes Aktgjykimit për Denacionalizim. Humbja e posedimit ishte si rezultat i rrethanave në Kosovë gjatë viteve 1998/1999.
2. Për të mbështetur kërkesat e tij, pala ankuese ka dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
 - Aktgjykimin nr. 155/90 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë më 5 dhjetor 1994, me të cilin është vërtetuar se paraqitësit e kërkesës, V dhe L J janë pronarë të ngastrës kadastrale nr. 955, që ndodhet në vendin e quajtur “Beli Luk” me sipërfaqe prej 03.67.83 ha dhe ngastrës kadastrale nr. 1298/6 që ndodhet në vendin e quajtur “Beli Luk” me sipërfaqe prej 01.15.62 ha. Të dy ngastrat kadastrale ceken në Fletën Poseduese nr. 147 në emër të Kooperativës Bujqësore Vitia, kështu, Ndërmarrja “A” në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë ishte obliguar t’ia njeh të drejtën pronësore mbi pronat e lartpërmendura paraqitësve të kërkesës, t’ia dorëzoj posedimin e pronave të lartpërmendura paraqitësve të kërkesës si dhe të lejoj paraqitësit e kërkesës të bëjnë ndryshimet kadastrale,
 - Kopjen e Planit nr. 147 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër i Komunës së Vitisë në vitin 1995, ku ceket prona e kërkuar si Pronë Shoqërore “Z Z/K B” V,
 - Kërkesën e paraqitur në Agjencinë Kadastrale të Kosovës nga L dhe V J për zbatimin e ndryshimeve në Kadastër,
 - Certifikatën e vdekjes nr. 203-42/04-35 të lëshuar më 27 shkurt 2004 nga Zyra e Regjistrimit Civil në Kragujevc, që dëshmonte se L J kishte vdekur më 22 shkurt 2004,
 - Mendimin Profesional të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës më 10 janar 2005 lidhur me kërkesën e V dhe L J për regjistrimin e të drejtës pronësore në emrat e tyre.

Agjencia Kadastrale e Kosovës e vërtetoi se pas lëshimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe brenda afatit ligjor vendosi lidhur me kërkesën,

- Vendimin nr. 245/2007 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë më 11 janar 2008 me të cilin gjykata lejon kryerjen e ndryshimeve kadastrale në emër të V dhe L J. Baza ligjore për ndryshimet ishte Aktgjykimi nr. 155/90. Drejtorati për Kadastër ishte i obliguar të zbatonte ndryshimet menjëherë pasi që vendimi të hynte në fuqi (25 shkurt 2008),
 - Vendimin Kadastral nr. 489 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës më 13 nëntor 2008. Sipas këtij vendimi, kushtet për regjistrim e të drejtave pronësore në emër të V dhe L J ishin përmbushur, megjithatë, kërkesa për kryerjen e ndryshimeve kadastrale ishte refuzuar për shkak të Vendimit të Asamblesë Komunale të Vitisë nr. 013/838 të datës 6 mars 2008 që përkohësisht e shtynte regjistrimin e pronave të paluajtshme që rridhnin nga ish-ndërmarrjet shoqërore në Kadastrin e të Drejtave Pronësore,
 - Vendimin Kadastral nr. 03/715/69 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës më 02 maj 2009 me të cilin ankesa e V dhe L J ndaj Vendimit Kadastral nr. 489 ishte refuzuar si e pabazuar,
 - Padinë nr. 478/09 të paraqitur në Gjykatën Supreme të Kosovës nga V dhe L J, që të dy në cilësinë e paraqitësve të kërkesës, më 25 qershor 2009 për anulimin e Vendimit Kadastral nr. 03/715/69 me të cilin ankesa e paraqitësve të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar.
3. Njoftimi i kërkesës ishte bërë më 1 qershor 2010 duke e publikuar kërkesën në Gazetën Zyrtare të AKP-së nr. 2 të datës 17 qershor 2010 dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista ishin lënë në Komunën e Vitisë, në hyrje dhe dalje të fshatit Gushicë. Publikimet e njëjta ishin lënë në Zyrën Kadastrale të Vitisë, Gjykatën Komunale të Vitisë dhe në Zyrën Rajonale të AKP-së në Prishtinë.
4. Më 29 shtator 2014, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë) përmes M S (zyrtar ligjor) i ishte qasur AKP-së duke shprehur interes ligjor në kërkesën në fjalë.

Për të mbështetur kërkesën pala përgjegjëse në ankesë kishte dorëzuar provat vijuese:

- Njoftimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit e cila i ishte përcjell Agjencisë Kosovare të Pronës më 29 shtator 2014 ku informohej Agjencia Kosovare e Pronës se Ndërmarrja “A” (në proces Likuidimi) është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ndërmarrja “A” i ishte nënshtruar procesit të likuidimit më 7 korrik 2014 në përputhje me Ligjin nr. 04/6-034. Pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të Ndërmarrjes “A”. V J ishte njoftuar për procesin e likuidimit më 16 korrik 2014 por ai nuk kishte paraqitur asnjë kërkesë lidhur me pronat e kërkuara,

- Fletën Poseduese nr. 147 të lëshuar nga Komuna e Vitisë, Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë më 15 maj 2007, ku cekeshin pronat e kërkuara si prona shoqërore në emër të Ndërmarrjes “A”
 - Njoftimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit nr. 16295/2014, të datës 16 korrik 2014 ku informohej V J lidhur me procesin e likuidimit të pronave të kërkuara.
 - Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr. 4013/2014, të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Vitisë më 24 shtator 2014, ku përmendeshin pronat e kërkuara në emër të Ndërmarrjes “A”.
5. Më 30 mars 2015, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës e kishte hedhur poshtë kërkesën përmes vendimit KPCC/D/A/267/2015. Në paragrafët 18, 19 dhe 20 të Vendimit Grupor, i cili sipas Vendimit të Vërtetuar zbatohet në veçanti ndaj kërkesave në fjalë, thuhet se sipas përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pronat e kërkuara në vitin 2002 janë vendosur nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (dhe rrjedhimisht suksesorit të saj Agjencisë Kosovare të Privatizimit) mbi bazën e miratimit të Rregullores së UNMIK-it 2002/12, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18. Sipas përfaqësuesit, Ndërmarrja “A” është në proces likuidimi dhe prandaj prona e kërkuar bie ekskluzivisht nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 4.1 (c) dhe nenit 5.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 mbi Dhomën e Posaçme. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se bartësi i supozuar i të drejtës pronësore nuk e kishte humbur aftësinë për të ushtruar të drejtat e tij si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999 por si rezultat i procesit të privatizimit që kishte pasuar më vonë, rrjedhimisht, kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit. Komisioni konstaton se vendimi nuk e paragjykon të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të kërkuar zgjidhje pranë gjykatës së juridiksionit përkatës.
6. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 4 qershor 2015. Ai kishte paraqitur ankesë më 25 qershor 2015.

Pretendimet e palës ankuese

7. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe asaj procedurale si dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.
8. Pala ankuese thekson se nuk është e vërtetë se familja e tij nuk e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar për shkak të konfliktit.
9. Pala ankuese thekson se familja e tij i kishte fituar të drejtat pronësore mbi pronën e kërkuar në vitin 1994 mbi bazën e Aktgjykimit nr. 155/90.
10. Sipas palës ankuese, fakti që ai nuk është regjistruar në librat kadastral si pronar i pronës së kërkuar nuk mund të jetë arsye për të hedhur poshtë kërkesën e tij.

11. Bazuar në atë që u tha më lartë, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të anulohet vendimin e KKKP-së dhe të vërtetohet të drejtën e ri-posedimit në emër të tij.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është paraqitur brenda 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

Meritat e ankesës

13. Gjykata Supreme ka shqyrtuar vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejshëm: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese ajo gjeti se ankesa është e pabazuar.
14. Gjykata Supreme konstaton se KKKP-ja ka marrë vendim të drejtë kur e kishte hedhur poshtë kërkesën për shkak të juridiksionit të tij.
15. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdher nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën e paluajtshme private apo të drejtat e shfrytëzimit mbi të, por edhe që ai apo ajo nuk është në gjendje që aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
16. Së pari, pala ankuese thekson se familja e tij e kishte fituar të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar mbi bazën e Aktgjykimit nr. 155/90 të lëshuar nga Gjykata Komonale e Vitisë.
17. Sipas nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Gazeta Zyrtare nr. 6/80) që ishte në zbatim në kohën kur Aktgjykimi nr. 723/90 ishte lëshuar (viti 1993), e drejta e pronësisë mund të fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik (bartjes ligjore) apo me trashëgim.
18. Megjithatë, neni 33 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ e RSFJ-së, nr. 6/80), thekson se në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në "librin publik" (librin kadastral) ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.
19. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte gjetur *ex officio* Certifikatat mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme që shfaqnin pronën e kërkuar të regjistruar në emër të Ndërmarrjes "A".

20. Kjo shpie në konstatimin se familja e palës ankuese nuk e ka fituar të drejtën pronësore pasi që kërkesat e nenit 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (RSFJ-së, nr. 6/80) nuk ishin përmbushur.
21. Prona e kërkuar ishte dhe ende është e regjistruar në emër të Ndërmarrjes “A”, që do të thotë se ajo ka qenë dhe ende është pronë shoqërore. Sipas nenit 321, paragrafit 1 të LPK-së nuk ka nevojë të dëshmohen as faktet që janë të njohura botërisht dhe as faktet që janë dëshmuar përmes vendimeve të mëhershme gjyqësore.
22. Vërtetimi dhe mbrojtja e të drejtave pronësore ndaj pronave shoqërore dhe/ose pronave publike nuk është në juridiksion të KKPK-së, respektivisht Kolegjit të Apelit të AKP-së.
23. Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale dhe as vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.
24. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar të drejtat e tij pranë gjykatës kompetente, nëse ai këtë e sheh të nevojshme.
25. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Isa Kelmendi, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it